



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 61, datë 26.03.2025

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
KAMËZ, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.1, DATË 27.07.2022
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.1, datë 27.07.2022 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kamëz”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Korçë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.107, datë 05.11.2024, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Kamëz, të miratuar me Vendimin Nr.1, datë 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, të bëhen ndryshime në:

- *Dokumentin e Rregullores së Planit:*
 - Pika 1 “Veprimtaritë përbri brigjeve” e nenit 30, ndryshohet ;
 - Pika 4 “Kufizimi i zhvillimit në afërsi të vijës hekurudhore” e nenit 30, ndryshohet;
 - Në nenin 30 “Rregulla kufizuese në zonat për zhvillim” pas pikës 5) shtohen pikat 5.1) dhe 5.2);
 - Në nenin 65 “Kushte të tjera për zhvillimin e Kategorisë Infrastruktura Ujësjellës Kanalizime (IUK), pas pikës 3) shtohen pikat 4), 5) dhe 6);”
 - Neni 83 “Zhvillimi i Agroturizmit dhe Ekoturizmit”, ndryshohet;
 - Pika 2 e nenit 84 “Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror” ndryshohet;
- *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;*



MINISTRI
172

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kamëz, bashkëlidhur
këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Kamëz dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e
Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit,
si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të
miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Kamëz, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet
përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

